

PLAN PROGRAMI DITOR

Hivzi Muharremi

ARTI FIGURATIV 9


ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: ARTET Lënda: Art figurativ Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: IX	
Tema (nga– plani dymujor):Krijimtaria dhe performanca artistike	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Realizon vizatimin bashkëkohor: përdor teknika të ndryshme të vizatimit
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I -1,5 II ;1, III ;5,6	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1.4,6	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore:Vizatimi	
Fjalët kyçe:Teknika, vizatimi, lapsi, goma, fletorja,etj,	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - Realizon vizatimin - Dallon dhe përdor teknika të reja - Zgjedh ngjyrat Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - Zbulon talentin - Shpreh ndjenjat përmes vizatimit - Zbulon teknika të reja 	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:Art figurativ 9 , interneti, vizatime, laps ,fletore vizatimi,ngjyra gomë etj.	
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gj. Shqipe, histori, gjeografi, art muzikor, ed. qytetare etj.	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse 10 min. Mësimdhënësi/ja shpjegon për vizatimin si teknikë e shpejtë për të realizuar një krijim. Çdo vizatim është bashkim pikash për të krijuar vija, forma, linja etj. Vizatimi realizohet me mjete: laps, karbon etj.

Pjesa kryesore (Realizim kuptimi) 25 mn. Mësimdhënësi /ja shpjegon teknika të vizatimit dhe përdorimin e ngjyrave. Për inspirim, mësimdhënësi nxjerr dy piktura vizatime para nxënësve.

Reflektimi 10 min. Bashkë me nxënësit, mësimdhënësi/ja bën vlerësimin e punimeve.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi do të jetë i vazhdueshëm, çdo orë mësimore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësi realizon një punim të lirë me laps.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Në bazë të përgjigjeve që japin nxënësit, mësimdhënësi/ja merr masat që ora tjetër të jetë shumë më atraktive dhe më e suksesshme.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Artet Lënda: Art figurativ Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: IX	
Tema (nga– plani dymujor):Krijimi dhe performanca artistike	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Realizon punimet e pikturës duke përdor teknika bashkëkohore
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	
I.1,2	II .1,3
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1 .4,6	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore:Piktura	
Fjalët kyçe:Piktura, teknikë, stil, vepër, tempero etj.	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - Dallon pikturën nga format e tjera - Identifikon degët e pikturës - Zgjedh mjetet e pikturës Kriteret e suksesit: - Shpreh emocionet përmes pikturës - Emërton lloje të ndryshme stilesh të pikturave - Njeh dhe trego cilës rrymë i takon një vepër	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:Arti figurativ 9 , innterneti, lapsi, goma, fletore e artit figurativ etj.	
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:Art muzikor gj.shqipe, histori , ed. Qytetare etj.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	

Pjesa hyrëse 10 min. Mësimdhënësi/ja shpjegon për pikturën si degë e artit figurativ. Pasi të shpjegojë, mësimdhënësi/ja e nxjerr përpara nxënësve ndonjë pikturë , duke motivuar nxënësit për të punuar.

Pjesa kryesore 25 min. Mësimdhënësi/ja jep sqarime për stile dhe teknika të pikturave, duke plotësuar edhe me shembuj.

Pjesa përfundimtare- reflektimi 10 min. Arsimtari /ja diskuton me nxënësit për punimet e tyre dhe i udhëzon ata për lëshimet eventuale.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi do të jetë i vazhdueshëm , d.m.th. çdo orë dhe pas çdo punimi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit do ta kryejnë punimin në shtëpi.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi u bën pyetje nxënësve për të mësuar çka nuk ka shkuar mirë dhe që duhet ndryshuar në të mirë të nxënësve.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Fusha kurrikulare: Artet / Lënda: Art figurativ Shkalla e kurrikulës: IV / Klasa: IX****Tema (nga– plani dymujor): Krijimi dhe performanca artistike****Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Gdhend shabllone për të shtypur imazhe grafike.****Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):****II: 1,5 III: 5,6****Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):****1. 4,6****ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Grafika****Fjalët kyçe: shtypi grafik, litografi, drugdhendja, bakërshkrim etj.****Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**

- Veçon grafikën nga nga format e tjera
- Dallan grafikët më të njohur
- Identifikon mjetet grafike

Kriteret e suksesit:


- Realizon një punim grafik
- Analizon punimin e vet dhe të tjerëve

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurati 9, interneti, foto, fletore të arti figurativ, laps, ngjyra etj.**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: gj. shqipe dhe letërsi, art muzikor, shkenca shoqërore etj.****PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

Pjesa hyrëse 10 min. Mësimdhënësi/ja jep informacione të duhura për grafikën .

Pjesa kryesore (R.K) 25min. Mësimdhënësi /ja kërkon nga nxënësit ta bëjnë një punim duke u bazuar në punimet e shfaqura para tyre dhe në librin e artit fiurativ.Mësimdhënësi/ja u ndihmon nxënësve në realizimin e punimit.

Reflektimi 10 min. Nxënësit diskutojnë për punimin dhe punën e tyre, sfidat për gjatë punës.



VLERËSIMI I NXËNËSV

Nxënësit do të diskutojnë për mjetet që i kanë përdorur për realizimin e punimit,kurse mësimdhënësi do të vlerësoj nxënësit në bazë të punimit dhe përgjigjeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Përfundoni punimin tuaj dhe ruajeni në protfolio.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Do të analizojmë përgjigjet në fletëvlerësime dhe do të bëjmë ndryshimin e duhur.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Fusha kurrikulare: Artet Lënda: Art figurativ Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: IX****Tema (nga– plani dymujor):**
Krijimtaria dhe performaca artistike**Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):**
Realizon skulptura me materiale dhe teknika të ndryshme.**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**
I:1, 2,5 II;1,**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :**
1. 4,6**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore:Skulptura****Fjalët kyçe:kulpturë, letër, modelim, gdhendje, tel etj.****Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**

- Identifikon disa teknika
- Modelon një maskë
- Dallon dhe përdor materialin

Kriteret e suksesit:

- Përgatit materialin për modelim
- Krijon një skulpturë
- Ndjek procedurat e krijimit

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:Art figurativ 9, interneti, fletore e vizatimit, gërshtë, letër, pastelinë etj.**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:****Gjuhë shqipe, art muzikor, histori, etj.**

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse 10min. Mësimdhënësi /ja shfaq materiale e mundësisht përmes videoprojektorit shpalos punën e modelimit , materialin ,punët dhe teknikat. Shih në foto maskat

Pjesa kryesore(Realizimi i kuptimit) 25 min. Nxënësit duhet respektuar rregullat e ofruara nga mësimdhënësi/ja për ta bërë skulpturën – maskën.

Pjesa përfundimtare(Reflekimi) 10 min. Pasi ta mbarojnë punën , nxënësit nxënësit do të prezantojnë punën e tyre , si e realizuan dhe çfarë vështirësish u dolën.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm ,protofolio , prezantim dhe instrumente të tjera të vlerësimit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Skiconi një ide tuajën dhe më pastaj realizoni një skulpturë me argjil ose pastelinë

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Çfarë keni për të shtuar për këtë orë mësimore? Doni ta zgjedhim ndonjë metodë ose teknikë tjetër? Pas përgjigjeve mësimdhënësi ndryshon.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Fusha kurrikulare: Artet Lënda: Art figurativ Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: IX****Tema (nga– plani dymujor):Krijimtaria dhe përformaca artistike****Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Dallon mediumet dhe teknologjitë e ndryshme të artit aplikativ****Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II: 3,5 III: 5,6 IV;2,4****Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :****1. 4,6****ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore:Artet aplikative****Fjalët kyçe:aplikative, të zbatuara, vizuele,dizajn, shfaqje ,koncert etj.****Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**

- Dallon artet aplikative
- Njihet me mundësitë që jep kjo degë e artit në jetën shoqërore
- Liston mundësitë e intervenimeve: kukulla,kapërtina ,pllakata,shfaqje etj.

Kriteret e suksesit:

- Dizajnon kapërtinën e fletores
- Identifikon teknikat
- Shpreh qëndrimin e tij për këtë fushë

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:Arti figurativ IX, interneti, fletorja e artit, lapsi , goma , imazhe revistash, gazetash, gërshërë, albume etj.**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:****Gjuhë shqipe, art muzikor, histori , edukatë qytetare etj.**

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse 10 min. Mësimdhënësi/ja do të japë imazhe, realizime të teknikave të krijimeve.

Pjesa kryesore (R.K) 25 min. Me anë të teknikës së stampimit nxënësit provojnë copëzave të prera nga revista, gazeta, etj. krijojnë imazhe e ngjarje të ndryshme.

Reflektimi 10 min. Pasi të kryhet aktiviteti dhe përafërsisht të jenë mbaruar nxënësit/et do të diskutojnë për realizimin e tyre.



ndryshme mbi realizimin e këtyre në fletoren e artit. Ata përmes detyrat e shtruara vetes,

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi do të bëhet gjatë reflektimit, kur nxënësit diskutojnë për punën e tyre dhe të shokëve –shoqeve të tyre

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Preni dhe ngjitni pjesë nga revista, gazeta etj. dhe krijoni imazhe-pejzazhe të ngjyrosura për të krijuar diçka të veçantë.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Nxënësit/et do të shfaqin mendimin e tyre për orën mësimore duke treguar për motivimin e tyre , për punë dhe sfidat e tyre gjatë realizimit.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare:Artet Lënda: Art figurativ Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: IX	
Tema (nga– plani dymujor):Krijimtaria dhe performanca artistike	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Dallon mediumet e ndryshme të artit aplikativ,realizon punime të ndryshme në dizajn.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II: 1 III: 5 IV;2,4 VI;9	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) 1.4,6	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore:Dizajni	
Fjalët kyçe:Dizajn, kukulla,fustana, tepih,tekstil,shfaqje etj.	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - Dallon format dhe mundësitë e aplikimit të dizajnit - Realizon punime dekorative - Dizajnon fustan Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - Identifikon dizajnin industrial - Dizajnon një shenjë komunikacioni 	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:Arti figurativ 9 , interneti ,fletorja e artit figurativ, lapsi ,goma	
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:gjuhë shqipe, arte, histori , edukatë qytetare etj.	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse 10 min. Mësimdhënësi/ja shfaq imazhe të dizajnit dhe i pyet nxënësit se cila degë e artit është kjo. Cilat janë mjetet me të cilat realizohet, çfarë rëndësie ka dizajni në jetën e përditshme etj.?

Pjesa kryesore (R.K) 25 min.

Mësimdhënësi/ja shpalos vepra të dizajnuara dhe shpjegon mënyrat dhe veprimet për veprim. Nxënësit përcaktohen për punën dhe vazhdojnë për ta realizuar punimin.

Relektimi 10 min. Prezentimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Realizimi i punimeve , prezentimi, vlerësimi dhe vetëvlerësimi i tyre ,protofoli dhe prezentimi me gojë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Realizoni shenja komunikacioni , duke dizajnuar ashtu siç e kërkon rregulli.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Sa keni qenë të motivuar për punë? Çfarë u ka pëlqyer më shumë? Çfarë duhet ndryshuar? Përgjigjet e nxënësve ndihmojnë shumë në rezultatet e dyanshme.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Artet Lënda: Art figurativ Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: IX	
Tema (nga– plani dymujor):Krijimtaria dhe performaca artistike	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Realizon punime të ndryshme në multimedia
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I: 5,8 II: 1 III: 6 IV;4	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1. 4,6	

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:Multimedia dhe postproduksioni

Fjalët kyçe:Multimedia, postproduksion, video, audiencë,fotografi, dizajn,

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- **Dallon drejtimet dhe mediumet e ndryshme**
- **Realizon punime në mediumin e pikturës**
- **Përdor teknika bashkëkohore**

Kriteret e suksesit:

- **Identifikon medime të ndryshme**
- **Realizon dhe përdor teknika bashkëkohore**
- **Vlerëson punën në medime**

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:Arti figurativ 9 , interneti, fletorja e artit figurativ, lapsi, goma ,foto të ndryshme etj.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:Gjuhë shqipe, art muzikor , histori ,edukatë qytetare, edukimi për media etj.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse 10 min. Mësimdhënësi/ja shfaq foto të ndryshme dhe i pyet nxënësit : Çfarë shihni?

Pjesa kryesore (R.K)25 min. Mësimdhënësi/ja përgatit projektorin dhe me shembuj dhe tekst shpjegon prejardhjen , kohën dhe domethënien e medimeve .Nxënësit bëjnë një punim me mjete mediale.

Reflektimi 10 min.Nxënësit diskutojnë për multimediat, rëndësinë dhe efektet në shoqëri.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Përgjigjet dhe vlerësimi dhe vetëvlerësimi i temave të realizuara, krijimet dhe prezentimet.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Çka kuptojmë me termin multimedia?

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Çfarë është me rëndësi të ndryshojmë për të qenë ora më atraktive dhe relaksuese?

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Fusha kurrikulare: Artet Lënda: Art figurativ Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: IX****Tema (nga– plani dymujor):Krijimtaria dhe performanca artistike****Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):Realizon fotografi artistike me teknologji të reja . Dallon fotografët më të njohur****Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):****I : 1,5 II: 1,3 IV;1,8****Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :****1. 4,6****ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore:Fotografia artistike****Fjalët kyçe:fotografi. Portret, peisazh,objektiv,krijues , teknikë e re****Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**

- Dallon gjinitë e fotografisë
- Përdor aparatit fotografik
- Realizon foto

Kriteret e suksesit:

- Diskuton për fotografinë
- Realizon foto artistike

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:Arti figurativ 9, interneti, fotografi të ndryshme ,portrete, aparat fotografik etj.**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:Gj. shqipe , art muzikor, histori , ed.qytetare etj.**

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse 10 min. Mësimdhënësi/ja paraqet imazhe fotografike dhe u jep informacione nxënësve për rolin dhe rëndësinë e fotografisë. Bashkë me nxënësit, mësimdhënësi këmben mendime dhe informata mbi aparatën dhe teknologjitë e reja.

Pjesa kryesore 25 min. Nën udhëheqjen e mësimdhënësit/es nxënësit praktikisht demonstrojnë punën praktike, duke realizuar një numër fotosh të bazuara në gjinitë e fotografisë

Reflektimi 10 min. Pasi nxënësit ta kenë mbaruar punën, do të analizojmë punën e bërë, mënyrën e realizimit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi do të përqëndrohet te diskutimet, realizimet, vlerësimet e nxënësve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Zgjidhni dhe realizoni një nga gjinitë e fotografisë: fotoreportazh, fotografi, pejzazhi etj.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

A është realizuar kënaqshëm ora mësimore?

Sa e keni përvetësuar këtë gjini të fotografisë?

Çfarë duhet shtuar?

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Artet Lënda: Art figurativ Shkalla e kurrikulës: IV Klasa:IX	
Tema (nga– plani dymujor):Krijimtaria dhe performanca artistike	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Realizon maketa të objekteve të arkitekturës bashkëkohore,identifikon arkitektët më të njohur
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I: 1,5,8 II: 1,5 III: 6	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1. 4,6	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore:Arkitektura	
Fjalët kyçe:Arkitektura, konstruksion, dimensione, struktura ,piramida , pallate etj.	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - Realizon maketa të objekteve - Dallon arkitekturën nga fushat e tjera - Identifikon arkitektët më të njohur Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - Realizon objekte maketi - Diskuton për strukturën arkitekturale - Analizon objektin prej maketi 	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:Arti figurativ 9 , interneti ,fletorja e artit, goma , lapsi, karton ,plastikë, kapsa, etj.	
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:gj.shqipe, histori, art muzikor, histori ,edukim medial ,edukim qytetar etj.	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse 10 min. Mësimdhënësi/ja shpalos disa fotografi arkitektonike dhe përmes pyetjeve nxjerr qëllimin e orës .

Çfarë shihni në figurë? Çfarë lloj ndërtese po shihni?

Pjesa kryesore (R.K) 25 min. Mësimdhënësi /ja shpjegon konstruksione të arkitekturës dhe bën dallime midis stileve të saj. Më pas merr mendime dhe përgjigje nga nxënësit mbi materialet ricikluese dhe mundësia për t'i përdorur ato dhe për të krijuar vepra arti.

Nxënësit krijojnë një vepër arkitektonike.

Reflektimi 10 min. Nxënësit do të identifikojnë arkitektët më të njohur botërorë dhe do të diskutojnë për veprën e bërë dhe materialin e përdorur.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi do të bëhet për realizimin e punimit , diskutimit , prezentimit me gojë dhe me shkrim .

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Realizoni në shtëpi një detyrë kolazhi me materiale të ndryshme sipas dëshirës dhe mundësisë .

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Çfarë ju pëlqeu më shumë ?

Cilat ishin vështirësitë për realizimin e punimit ?

Nga përgjigjet mësimdhënësi/ja bënë ndryshimet për orën e ardhëshme.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Fusha kurrikulare: Artet Lënda: Arti figurativ Shkalla e kurrikulës:IV Klasa: IX****Tema (nga– plani dymujor):****Krijimtaria dhe performanca artistike****Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):****Identifikon artistët më të njohur të medimeve bashkëkohore të instalacionit , artit publik , video artit dhe performancës .****Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):****I: 1,5 . III :2,5. IV:1,2,3,4.****Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :****1.4,6****ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Arti publik, video arti , instalacioni dhe performanca .****Fjalët kyçe: Art publik, video art , instalacion , performanca , nocion , kamerë etj.****Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**

- Liston emrat e njohur që krijuan artin publik , video artin etj.
- Dallon video artin nga fushat e tjera .
- Veçon piktorët shqiptarë të Kosovës që performuan në kompleksin “Qafa” .

Kriteret e suksesit:

- Dallon nocionin art publik.
- Veçon teknologjitë e reja.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ IX , interneti , fletorja e artit figurativ, lapsi dhe fletorja, fotot e ndryshme si dhe aparat fotografik, video etj.**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:****Gjuhë shqipe, Art muzikor, Informatikë, Edukim medial,etj.**

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse 10 min.

Mësimdhënësi/ja shpalos foto të artit publik , video artit , të instalacionit dhe të performancës para nxënësëve dhe shtron pyetje për to. Pasi t'i merr përgjigjet , mësimdhënësi/ja shpjegon për disiplinat në fjalë .

Pjesa kryesore (R.K) 25 min.

Mësimdhënësi/ja jep informata shtesë për artin publik, video artin, instalacionin dhe performancën , kurse nxënësit provojnë të bëjnë video artistike të metrazhit të shkurtër në ambiente të ndryshme.

Reflektimi 10 min.

Nxënësit japin mendime për artin publik, video artin, instalacionin dhe performancën duke iu përgjigjur pyetjeve të mësimdhënësit/es.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në bazë të përgjigjeve dhe aktivitetit në klasë nxënësit do të vlerësohen në fund të orës .

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punoni një punim të huazuar nga arti publik.

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja do të shtrojë pyetje për nxënësit në mënyrë që ta shohë se si ka rrjedhur ora mësimore . Në bazë të përgjigjeve dhe atmosferës në klasë mësimdhënësi/ja do të marrin masat përmirësuese në orët e tjera .

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Fusha kurrikulare: Artet Lënda: Arti figurativ Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: IX****Tema (nga– plani dymujor):
Elementet figurative****Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor):
Përdor elementet figurative në realizimin e punimeve artistike. Dallon dhe analizon elementet figurative në veprat e artistëve të njohur . Dallon dhe përdor llojet e ndryshme të vijave .****Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.1,8 II.1,3,5 III.2,5****Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :
2.1,2,3,****ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore: Vija****Fjalët kyçe: Vija, piktura , skica , vizatimi , lloji dhe krijimi.****Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**

- Dallon vijën në vizatim e pikturë
- Identifikon llojet e vijave
- Realizon një krijim artistik – përdor vijën

Kriteret e suksesit:

- Njih llojet e vijave
- Shpreh emocionet në krijim artistik.
- Dallon dhe përdor llojet e ndryshme të vijave.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**Arti figurativ IX , interneti , fletorja e artit figurativ, lapsi dhe thëngjilli , kartoni ,tempera , etj.****Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:****Gjuhë shqipe , Art muzikor , Edukatë qytetare , Histori etj.**


PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrëse 10 min. Mësimdhënësi/ja shpjegon ç'është vija , ku mund të përdoret vija ?

Çfarë krijojmë me vija?

Pjesa kryesore (R.K) 25 min. Mësimdhënësi/ja në pjesën hyrëse ka marrë disa përgjigje , kurse për pyetjet që nuk ka marrë përgjigje ai/ajo do të japë informacione mbi vijën , rëndësinë e saj në artin pamor për të shprehur emocione , lëvizje , formë , dinamizëm , etj. Nxënësit realizojnë një punim artistik .

Pjesa përfundimtare (Reflektimi) 10 min. Nxënësit analizojnë punimet e tyre dhe tregojnë me çfarë janë realizuar dhe çfarë pasqyrojnë.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi do të përfshijë vlerësimin dhe vetëvlerësimin e punimeve të realizuara me teknika të ndryshme artistike dhe të prezentuara edhe me gojë .

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Bëni një portret të ndonjë figure të shquar kombëtare .

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja përgatit fleta vlerësuese për orën e mësimimit .

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Artet Lënda: Art figurativ Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: IX	
Tema (nga– plani dymujor): Elementet figurative	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Dallon forma dy dhe tredimensionale në punime skulpturale .
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.2 II.1,5 III.2,5,6 IV.12	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 2.1,2,3	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Forma	
Fjalët kyçe: Forma , dydimensionale , tredimensionale , sipërfaqe , vëllim , strukturë , ngjyrë .	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - Modelon këmbën me tel ose material të butë , - Dallon formën tredimensionale , - Realizon punimin . Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - Veçon formën tredimensionale nga forma dydimensionale , - Realizon punimin me materiale të buta. 	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Arti figurativ IX , interneti , fletorja e artit figurativ , Lapsi dhe goma , materiali i butë ose teli .	
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe , Art muzikor , Histori , Edukatë qytetare etj.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	

Pjesa hyrëse 10 min. Mësimdhënësi/ja paraqesin (demonstrojnë) disa fotografi ku tregohen format dydimensionale dhe tredimensionale dhe e bëjnë dallimin e tyre. Format tredimensionale i shohim nga të gjitha anët prandaj i quajmë ndryshe skulpturë.


Pjesa kryesore (R.K) 25 min. Nxënësit krijojnë një punim tredimensional me materiale të ndryshme duke u mbështetur në fotot e librit.

Faza e parë me tel japin formën.

Faza e dytë e mbushin sipërfaqen.

Faza e tretë e bëjnë lyerjen me material të butë ose me ngjyrë.

Pjesa përfundimtare (Reflektimi) 10 min. Nxënësit pasi ta kenë mbaruar punimin debatojnë për punën , mënyrën e realizimit dhe vështirësit gjatë realizimit.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi do të përqendrohet për diskutimet , punën , realizimin dhe analizën e punimit të nxënësëve .

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Modelo Hyjneshën në fron

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja përgatit fleta vlerësuese për orën e mësimimit .

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Art figurativ	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema (nga– plani dymujor): Elementet figurative		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Dallon ndarjen e ngjyrave primare , sekondare , terciare , plotësuese , analoge , të ftohta dhe të ngrohta ; Përdor nuancat e ngjyrave në punimet artistike .	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1 ,2 II.1,2 III.2,5,8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 2.1,2,3			
